



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi  
VENDIM

Nr. 196, datë 12.12.2019

MBI

**KËRKESËN E SHOQËRISË KESH SH.A. PËR RISHIKIMIN E VENDIMIT NR. 167,  
DATE 04.11.2019, "MBI MIRATIMIN E DRAFT  
KONTRATËS PËR SHIT-BLERJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE NDËRMJET  
SHOQËRISË SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE KESH SH.A., AKSIONET  
E TË CILËS KONTROLLOHEN PLOTËSISHT OSE PJESËRISHT NGA SHTETI DHE  
FURNIZUESIT TE SHËRBIMIT UNIVERSAL/OSHEE SH.A., PËR  
FURNIZIMIN E KLIENTËVE FUNDORË PËR PERIUdhËN KOHORE 01.01.2019 -  
31.12.2019"**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, nenit 16 të “Rregullores të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.12.2019 mbasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria “KESH“ sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Çështjeve ligjore nr. 114/6 Prot, datë 04.11.2019, mbi kërkesën e shoqërisë KESH sh.a. për rishikimin e vendimit të bordit të ERE nr. 167 datë, 04.11.2019, “Mbi miratimin e draft kontratës për shit-blejjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike KESH sh.a., aksionet e të cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal/OSHEE sh.a., për furnizimin e klientëve fundorë për periudhën kohore 01.01.2019 -31.12.2019”,

**Konstatoi se:**

- Me vendim nr. 167, datë 04.11.2019, bordi i ERE është shprehur për miratimin e draft kontratës për shit-blejjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike/kesh sh.a., aksionet e të cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe furnizuesit të shërbimit universal/OSHEE sh.a., për furnizimin e klientëve fundorë për periudhën kohore 01.01.2019 – 31.12.2019, me ndryshimet e evidentuara në vendim.
- Shoqëria KESH sh.a. me shkresën nr. 5280/1, datë 15.11.2019, protokolluar në ERE me nr.716/2 Prot, datë 15.11.2019, i është drejtuar ERE-s më kërkesën për rishikimin e vendimit të bordit të ERE nr. 167, datë 04.11.2019, "Mbi miratimin e draft kontratës për shit-blejjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjise elektrike KESH sh.a., aksionet e të cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe

furnizuesit të shërbimit universal/OSHEE sh.a., për furnizimin e klientëve fundorë për periudhën kohore 01.01.2019 -31.12.2019".

- Neni 16 i Rregullores se organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE, parashikon se: *Për një vendim të Bordit, çdo palë e përfshirë në një procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit lidhur me atë procedurë, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabimet materiale të konstatuara.*
  - Në lidhje me plotësimin e kushtit për depozitimin e kërkesës brenda afatit të parashikuar në rregullore, rezulton se KESH sh.a. ka ankimuar vendimin e sipërcituar, brenda afateve të parashikuara në rregullore.
  - Sa i përket provave të reja, të tilla që mund të çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga ai 167/2019, shpjegojmë në vijim duke analizuar pikë për pikë pretendimet e palës ankimuese.
1. *Në seancat dëgjimore u diskutua që palët e lënë në vlerësimin e Bordit çështjen e periudhës që rregullon kontrata edhe pse në tërësi marredhënia vjetore do të rregullohej bazuar në kontratën e periudhës 01.01.2018-31.12.2018, të lënë në fuqi për periudhën Janar dhe Shkurt, dhe periudha vijuese nga kontrata e nënshkruar nga palët.*
  2. *Sa i përket nenit 9 të kontratës të nënshkruar, parashikimi për depozitimin e të gjitha të ardhurava nga shitja në treg të parregulluar, cilësohet nga ERE se bie ndesh me parashikimin e VKM nr. 244/2016 në të cilën nenin 5.1 të saj që përcakton se: "Në cdo rast të vendosjes së detyrimit pubhik ndaj shoqërisë së prodhimit, aksionet e së cilës kontrohohen plotësisht apo pjesërisht nga shteti, Asambleja e Përgjithshme e kësaj shoqënie, pasi merr mendimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, viereson rast pas rasti mbi mënyren e përdorimit të të ardhurave shtesë mbi ato të parashikuara në programin ekonomik...", duke qënë se shoqëria e prodhimit të vetmet të ardhura që mund të sigurojë mbi ato të kësaj kontrate janë ato nga shitja në treg të parregulluar fondi do të humbiste qëllimin për të qënë garanci kontrate por prezumohet si një fond rezervë për krijimin e të cillt duhet më parë miratimi i MIE dhe mendimi i MEF, fakt që na është bërë me dije se nuk ekziston si rrjedhojë parashikimi se Shitësi nuk do ti përdore këto të ardhura për asnjë qëllim tjetër është jashtë kontekstit të së drejtës së këtij të fundit.*
  3. *Neni 9 pika 1.2 parashikon ndër të tjera se; Vlera e kompensimit për blerësin do të jetë për sasinë e paplotësuar pas rakordimit vjetor, por nuk do të jetë më e madhe se vlera e llogarisë escrow nga të ardhurat e siguruar nga shitja në treg të parregulluar Ky parashikim bie ndesh me parashikimin e përmendur dhe me sipër të VKM nr.244/2016 "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike", i ndryshuar, në nenin 5.3 pika 3 parashikohet ndër të tjera se, citojmë: Furnizuesi i Shërbimit Universal kompensohet nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike për sasinë e pasiguar nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike sipas vlerës së përcaktuar në kontratë" si*

rrjedhje vlera maksimale e kompensimit është përcaktuar tashmë nga ana e VKM nr.244/2016 dhe nuk është lënë në dëshirën e palëve. I njëjti konstatim vlen dhe për nenin 9 pika 1.3 pjesa; citojmë: Nëse vlera maksimale e kompensimit nuk është akumuluar në llogarinë e posaçme, atëherë vlera e kompensimit do të jetë ajo shumë e akumuluar në këtë llogari.

4. Gjithashtu edhe vetë koha e trajtimit të kontratës së nënshkruar mes palëve dhe miratimit të saj me ndryshime në fund të vitit ushtrimor, pavarësisht se në fuqi qëndronte kontrata e periudhës së kaluar 01.01.2018-31.12.2018, duhet të vlerësohet, në mënyrë që marrëdhëniet e palëve të vijojnë të ndërtohen në frymën e sigurisë rregullatore dhe ligjore dhe jo atë të pasigurisë.
5. Në pikën 3 të dispozitivit të vendimit vendoset një parashikim/detyrim i cili nuk ka qenë objekt diskutimi për përmbajtjen e kontratës, duke u paraqitur si rrethanë e re e pa njohur dhe e pa trajtuar gjatë procedurës së iniciuar për miratimin e kontratës. Përsa i përket anës materiale të kësaj pike të vendimit lidhur me sa trajton dhe hapësirave për interpretim që krijon, na bën të vlerësojmë se jemi në kushtet kur vendimi duhet rishikuar dhe kjo pikë e dispozitivit duhet saktësuar ose anuluar. Më konkretisht në pikën 3 të dispozitivit të vendimit të bordit të ERE Nr.167/2019 parashikohet se: "Për periudhën nga 01.01.2019 - deri në hyrjen në fuqi të këtij vendimi, nëse sasia e energjise se livruar dhe të marrë, ndryshon nga sasia e energjise se programuar për Iivrim, faturimet do të axhustohen nga palët në këtë kontratë për të reflektuar ndryshimet e devjimet midis prograrnit dhe sasisë aktuale të livruar brenda muajit nëntor 2019. **Ndërkohe, nëse i referohemi në mënyrë të veçantë përmbajtjes së pikës 3 të dispozitivit të vendimit, konstatojmë se nuk jemi dhe nuk mund të jemi në kushtet e zbatimit të këtij përcaktimi për sa kohë që faturimi i energjisë elektrike nga ana e KESH sh.a. është bërë bazuar në energjinë e nominuar (në DAMAS) dhe jo atë të kontraktuar (vjetore 3,950 GWh me bazë mujore).** Kjo e fundit është baza për përlllogaritjen e kompensimit financiar në rastet kur sasia e nominuar (DAMAS) është e ndryshme nga ajo e programuar (kontraktuar për vitin) dhe kjo sasi nuk është arritur të nominohet (konfirmohet) jo për faj të shitësit (mospeformanca e shitesit).
6. Edhe pse janë realizuar ndryshime thelbësore, janë lënë të pa ndryshuara disa nga parashikimet e kontratës së nënshkruar mes palëve, të cilat lidheshin në tërësi me parashikimet e rindryshuara dhe që rrjedhimisht e humbin kontekstin e tyre rregullator në marrëdhënien mes paleve, siç është llogaria Escrow.

### **Konstatimet mbi pretendimet e shoqërisë KESH sh.a..**

1. Sa i përket pretendimit 1, sqarojmë se: me vendimin 16/2019 është vendosur shtyrja e fuqisë juridike të kontratës së vitit 2018, deri në miratimin e kontratës 2019, dhe jo për periudhën janar – shkurt 2019, dhe pjesa tjetër me draft kontratën e nënshkruar mes palëve. Sa më sipër KESH është në kuptim të gabuar të parashikimeve të vendimit të ERE.

2. Në lidhje me pretendimin 2 sqarojmë: KESH sh.a. ndodhet në kushtet e kuptimit të gabuar të asaj që ERE ka parashikuar apo legjitimuar me ndryshimet e përcaktuara për këtë kontratë. Duke kufizuar akumulimin në llogarinë escrow me vetëm të ardhurat e nevojshme për qëllime të kompensimit të sasisë së energjisë së pasiguar në kuptim të kësaj kontrate, dhe jo siç ishte parashikuar nga palët, çdo të ardhur të siguruar nga shitja e energjisë në tregun e parregulluar, ajo që ka bërë ERE është pikërisht identifikimi i kësaj llogarie si një garanci kontrate e cila akulumon jo më shumë se të ardhurat e nevojshme me qëllim përmbushjen e kushteve të kësaj kontrate. Në të tilla rrethana, KESH sh.a. ndodhet në kushtet e lirisë së plotë por edhe detyrimit për përmbushjen e parashikimeve të VKM 244/2016 , të ndryshuar, për krijimin paralelisht të një fondi garancie që në kuptim të VKM sipërcituar të shërbejë për balancimin e të ardhurave dhe shpenzimeve të shoqërisë së prodhimit për periudhat e ardhshme, me qëllim minimizimin e riskut hidrologjik. Ky fond rezervë i cili mund të krijohet duke depozituar në të çdo të ardhur të ndryshme nga ato të mënjanuara për përmbushjen e kësaj kontrate, sigurisht që kërkon detyrimisht miratimin e Asamblesë së Përgjithshme dhe konsultimin me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave.
3. Në lidhje me pretendimin 3 sqarojmë se, *nëse ERE do të shprehej për pranimin e kërkesës së palëve që kompensimi i blerësit për sasinë e paplotësuar nga pala shitëse të bëhej me çmimin mesatar të shitjes së energjise nga ana e shitësit në tregun e parregulluar, kjo do të binte ndesh me sa parashikuar në VKM nr.244/2016, të ndryshuar, e cila parashikon që *Furnizuesi i Shërbimit Universal kompensohet nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike për sasinë e pasiguar nga shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike sipas vlerës së përcaktuar në kontratë. Çmimi/vlera e përcaktuar dhe miratuar nga Asmbleja e Përgjithshme e shoqërisë KESH sh.a. për qëllime të kësaj kontrate është çmimi i shitjes së energjisë elektrike, nga KESH për OSHEE. Edhe në kuptim të vlerës së miratuar në planin e zhvillimit ekonomik të shoqërisë KESH sh.a. për efekte të garantimit të kompensimit të sasisë së pasiguar për qëllime të kësaj kontrate është kalkuluar në raportin sasi e porealizuar me çmim të miratuar nga Asambleja në vlerën 1.5 lekë.* Sipas programit ekonomik, kjo sasi përbëhet nga Totali prodhimit neto KESH për vitin 2019 në sasinë 3,805,935 MWh plus zërin kompensim të shprehur në vlerë lekë në masën 216,097 (000 lekë), e cila prodhon si rezultante në MWh (216,097/1.5 leke/KWh= 144,064 MWh).*
4. Sa i përket pretendimit të KESH që kjo kontratë është miratuar në fund të vitit ushtrimor nga ERE, sqarojmë se: KESH është në dijeni të të gjithave korrespondencave e ka qënë prezent në të gjitha seancat dëgjimore të zhvilluara nga ERE me pjesëmarrjen e palëve në këtë kontratë por edhe të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, të cilat kanë qënë të domosdoshme për ERE-n për të marrë spjegime shteruese në lidhje me dispozitat e parashikuara e të dakortësuara për herë të të parë midis palëve në këtë kontratë e që binin ndesh me sa parashikuar edhe nga vetë VKM nr.244/2016, të ndryshuar. Përgjatë seancave dëgjimore të organizuara nga ERE, përfaqësuesit e OSHEE kanë deklaruar se kjo kontratë siç është propozuar nga palët, bie ndesh me parashikimet e VKM nr. 244/2016, të ndryshuar, por nuk do të bjerë ndesh me ndryshimet e propozuara nga OSHEE në këtë VKM. Këto ndryshime ende nuk janë miratuar, ndaj ERE ka gjuar e

vepruar për konsekuencë, mbi ligjin në fuqi që është VKM nr.244/2016, të ndryshuar, duke konstatuar çdo mospërputhje të kësaj kontrate mbi ligjin e zbatueshëm.

5. Sa i përket pretendimit të pestë sqarojmë se : Edhe në pikën 3 të vendimit nr.16/2019 është vendosur: “Për periudhën deri në miratimin e kontratës për shit-blerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike/KESH sh.a., aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe OSHEE sh.a. për vitin 2019, nëse sasia e energjisë së livruar dhe të marrë, ndryshon nga sasia e energjisë së programuar për livrim, faturimet do të axhustohen nga palët në këtë kontratë për të reflektuar ndryshimet e devijimet midis programit dhe sasisë aktuale të livruar.  
Ky vendim nuk është ankimuar nga palët të cilët kanë vepruar në dijeni të plotë të asaj që ka sanksionuar ERE në këtë vendimmarrje, duke iu lënë detyrë që deri në miratimin e kontratës së vitit 2019, palët duhet të operojnë mbi bazën e pritshmërisë për korrigjime nëse konstatojmë se sasia e energjisë së livruar dhe të marrë, ndryshon nga sasia e energjisë së programuar për livrim, faturimet do të axhustohen nga palët në këtë kontratë për të reflektuar ndryshimet e devijimet midis programit dhe sasisë aktuale të livruar.
- 6 Sa i përket pretendimin të gjashtë sqarojmë se: megjithëse KESH deklaroi se janë bërë ndryshime thelbësore, por janë lënë të pa ndryshuara disa nga parashikimet e kontratës së nënshkruar mes palëve, të cilat lidheshin në tërësi me parashikimet e rindryshuara dhe që rrjedhimisht e humbin kontekstin e tyre rregullator në marrëdhënien mes palëve, siç është llogaria Escrow, KESH nuk ka dhënë asnjë sqarim se cilat janë këto dispozita që kanë bërë që kontrata të humbë kuptimin e të shkojë në kundërshtim me vullnetin e palëve.
- 7 Në konkluzion të sa më sipër por edhe në vijim të parashtrimeve të përfaqësuesve të shoqërive KESH sh.a dhe OSHEE sh.a. në mbledhjen e bordit të ERE të datës 12.12.2019 nuk dokumentuan apo argumentuan mbështetjen në VKM nr. 244/2016, të ndryshuar, të ndryshimeve të draftit të kontratës së dakortësuar nga palët. Në thelb të këtyre argumentave, palët parashtruan dakortësinë mes tyre por nga ana tjetër VKM nr. 244/2016, i ndryshuar, qartësisht ka përcaktuar disa nga elementët e marrëdhënies së furnizimit për qellime të shërbimit publik nga KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a.
- 8 Duke vlerësuar se asnjë nga argumentat e parashtruar nga ankimuesi, KESH sh.a. nuk përbën provë të re, të tillë që të çojë bordin e ERE në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga ai nr.167/2019.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të rrëzojë kërkesën e shoqërisë KESH sh.a. për rishikimin e vendimit të bordit të ERE nr. 167, datë 04.11.2019, "Mbi miratimin e draft kontratës për shit-blerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike KESH sh.a., aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe furnizuesit të shërbimit universal/OSHEE sh.a., për furnizimin e klientëve fundorë për periudhën kohore

01.01.2019 - 31.12.2019" si të pambështetur në prova të reja, të tilla që mund të çojnë Bordin e ERE në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga vendimi nr. 167, datë 04.11.2019.

2. Drejtoria e Çështjeve Ligjore, të njoftojë ankimuesin dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**